

**Olimbi Velaj**

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

## **Folklori në Ballkan, subjektivizimi në studimet e shekullit të fundit, rasti i baladës së murimit**

*Balada e murimit është një nga baladat më të vjetra dhe më të njohura në rajonin e Ballkanit. Mbledhja e saj nisi në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë dhe po në këtë kohë shohim edhe studimet e para në lidhje me të. Në këtë punim, përmes metodës krahasuese, ne do të përqendrohemi mbi mënyrën se si është studiuar kjo baladë dhe se si ka ndikuar konteksti historik e kulturor në studimin e saj. Punimi mëton të hedhë dritë mbi arsyet që i udhëhoqën studiuesit drejt përfundimeve lokaliste dhe subjektive dhe pse qasjet nacionaliste dominuan studimet deri në shekullin e XXI.*

**Fjalë kyçe:** Balada e murimit, studimet, nacionalizëm, Ballkan, folklor, motive, origjinë.

### **Hyrje**

Balada e murimit bazohet në një motiv shumë të lashtë dhe të përbotshëm, siç është ai i sakrificës njerëzore për të siguruar qëndrueshmëri në ndërtim. Në variantet e saj të mbledhura dhe të publikuara, balada në këtë rajon flet për murimin e një gruaje në muret e një ndërtese që për nga rëndësia i kalon kufijtë e familjes ose fisit. Gruaja sakrifkohet për një të mirë të përgjithshme, e cila duket se është e domosdoshme.

Ajo është balada që më shumë se çdo baladë tjetër është marrë në konsideratë nga studiuesit e rajonit të Ballkanit dhe të tjerët që merren me folklorin në këtë rajon. Po ashtu ajo mbetet balada më e diskutuar për sa i përket origjinës dhe në të njëjtën kohë është balada më e diskutueshme për sa i përket interpretimit të përbajtjes.

Balada e murimit nisi të regjistrohej në shekullin e nëntëmbëdhjetë e deri pak pas mesit të shekullit të njëzetë. Ka vetëm pak raste të regjistrimit të saj në fundin e shekullit të tetëmbëdhjetë. Mbledhja dhe më pas interpretimi i kësaj balade ka një histori kombëtare për secilin nga popujt në folklorin e të cilëve ajo shfaqet. Kjo histori është e lidhur mjaft ngushtë me formimin e shteteve kombëtare dhe me romantizmin, që në Ballkan u përjetua si rilindje e vlerave

të trashëgimive kombëtare dhe kohë e shkëputjes nga sundimi shumëshekullor turk.

### **Romantizmi, folklori dhe nacionalizmi**

Vlerësimi i folklorit nisi me romantizmin. Ideja e krijimit të shteteve kombëtare nxiti “zbulimin” e folklorit, si një pjesë shumë e rëndësishme e trashëgimive kulturore të çdo kombi. Rasti i Xhejms Makfersonit (James Macpherson, 1736-1796) me botimin në vitin 1765 të përmbledhjes *Këngët e Osianit*, është pët t’u theksuar, jo vetëm si shprehje e interesit ndaj trashëgimisë së të parëve, por edhe si përpjekje përtej së zakonshmes për të vlerësuar folklorin kombëtar. Këto këngë dolën se ishin të falsifikuara. Por ky fakt, në vend që të bëhej mësim dhe të mos përhapej më tej, çuditërisht u përsërit nga shumë mbledhës të folklorit ose poetë të romantizmit. Në botimet e mëpasme ne shohim gjithashtu përpjekje për të modifikuar këngët ose baladat e mbledhura, sidomos në pjesën juglindore të kontinentit.

Idetë e Herderit (Johann Gottfried Herder, 1744-1803) ishin ato mbi të cilat u bazua nacionalizmi romantik. “Më duket se po vjen koha kur do të arrijmë të kthimi i sinqertë në gjuhën tonë, në meritat, në parimet dhe qëllimet e etërve tanë dhe të mësojmë prej tyre të vlerësojmë arin tonë”, shprehet Herderi (Wilson, 1973: 819). Ai u ndikua nga botimi i Makfersonit, por shkoi shumë më përtej me vlerësimin dhe ngritjen e një strukture idesh për nacionalizmin dhe u bë pionier i idesë së shtetit-komb, lëvizje që u materializua në atë kohë në Evropën qendrore e lindore.

Wilson shpjegon ndryshimin midis nacionalizmit romantik të vendeve perëndimore, i cili u mbështet më së shumti te Rilindja dhe te doktrina e Rusoit për sovranitetin popullor dhe pikëpamja e tij se janë njerëzit e thjeshtë depozituesit e vërtetë të qytetërimit (ide këto që u manifestuan qartë në revolucionet franceze dhe amerikane) dhe nacionalizmit romantik të vendeve në qendër dhe në skaj të kontinentit. Ai bën dallimin midis dy degëzimeve, nëse do të mund t’i quanim kështu kuptimet e mëpasme që mori gjatë interpretimit doktrina e Rusoit.

“Në kundërshtim me nacionalizmin liberal, nacionalizmi romantik theksoi pasionin dhe instinktin në vend të arsyes, dallimet kombëtare në vend të aspiratave të përbashkëta dhe, mbi të gjitha, ndërtimin e kombeve mbi traditat dhe mitet e së kaluarës, domethënë mbi folklor – në vend të realiteteve politike të së tashmes”, (Wilson, 1973: 820).

Ai sqaron se si Herderi zhvilloi idenë e tij, e cila u përqaftua gjerësisht në këtë pjesë të Evropës në atë kohë. Theksin Herderi e vë te folklori.

“Poezinë popullore ai e quajti *arkivat e një nacionaliteti, gjurmët e shpirtit të një kombi, zëri i gjallë i kombësive*. Nga ajo mund të mësohet mënyra e të menduarit të një kombësie dhe gjuha e saj e ndjenjës. Në ç’vend më të mirë mund të shkonte një njeri për të zbuluar shpirtin e një kombi, sesa te poezia popullore?” (Wilson, 1973: 826).

Në Ballkan mbledhja e folklorit filloi disa dekada më vonë sesa në vendet e Evropës perëndimore. Edhe këtu, midis mbledhësve regjistruhen raste të veçanta, flagrante si ai i Makfersonit, por në përgjithësi nuk kemi të bëjmë me falsifikime në masë. Duhet theksuar se vazhdimisht manifestohet një dëshirë e madhe e mbledhësve të folklorit për ta përmirësuar çdo variant të mbledhur. “Mësuesit ishin mbledhësit më të rëndësishëm të folklorit në Evropë gjatë dhe përtej shekullit të nëntëmbëdhjetë” (Herzfeld 2003: 292). Është e rëndësishme të theksojmë se zakonisht mbledhës të folklorit përveç mësuesve, kanë qenë edhe klerikët dhe, me raste, edhe njerëz të administratës. Kjo bëhet e qartë kur shohim biografitë e mbledhësve të hershëm të folklorit.

Në lidhje me po këtë ide shohim se si elitat intelektuale u nxitën për të vlerësuar trashëgiminë kombëtare, jo vetëm folklorin, por edhe gjuhën. Kjo lëvizje e nisur nga Herderi, tashmë po kthehej në një realitet në gjithë Evropën juglindore. Për gadishullin Ballkanik, Dennis P. Hupchick shprehet se:

“Intelektualët e Ballkanit në fillim të shekullit të 19-të ishin kryesisht të interesuar dhe përpiqeshin të formonin një version të standardizuar të gjuhëve të tyre dhe të mblidhnin folklorin që ishte dallues për kombet e tyre përkatëse, duke preferuar një ide “të shenjtërimin” të përveçimeve kombëtare, sesa të zhvillimeve të përbashkëta universale, duke kërkuar shembuj që do të dëshmonin konceptin kulturor të Volksgeistit post Herderian” (Hupchick 2002: 190).

Ndërsa studiuesi Benedikt Anderson thekson se si u krijuan kushtet për të mbërritur te stadi i kombit modern, gjë që nisi me raportin kapitalizëm-teknologji, me rolin që luajtën botimet, duke theksuar edhe se çfarë është komuniteti imagjinar:

Konvergenca e kapitalizmit dhe e teknologjisë së shtypit në kushtet e shumëllojshmërisë së pazakontë të gjuhës njerëzore krijoi mundësinë e një forme të re të *komunitetit të imagjinuar*, i cili në morfologjinë bazë të tij krijoi skenën për kombin modern. Shtrirja e mundshme e këtyre komuniteteve ishte në vetvete e kufizuar, dhe, në të njëjtën kohë, s’kishte asnjë lidhje me kufijtë politikë ekzistues (të cilët ishin, në përgjithësi, shenjat e ekspansionizmit të dinastive) (Anderson 1983: 58).

Në kontekstin e Ballkanit të fillimit të shekullit të nëntëmbëdhjetë ne mund të vërejmë të manifestuara qartë mjaft nga linjat e nacionalizmit romantik dhe të sjelljes ndaj folklorit. Mënyra se si ballkanasit iu drejtuan folklorit, krijimi i gjuhëve kombëtare, ideja e shtetit-komb, si dhe një lloj “konkurrence” për superioritetin kombëtar duke u krahasuar me fqinjët, janë “simptomat” e materializimit të ideve që qarkullonin asokohe për lidhjen midis trashëgimisë, kombit dhe aspiratës për të krijuar shtetin-komb.

Për ta pasur më të qartë këtë, po i referohemi një balade shumë të njohur dhe mjaft të përhapur në Ballkan, baladës së murimit. Kjo do të shërbejë edhe si shembull për të treguar se si u manifestua në këtë gadishull gjithçka që përmendëm më sipër, deri te mënyra se si studiuesit iu qasën për interpretim kësaj balade.

### **Balada e murimit në Ballkan, variantet dhe regjistrimi**

Për baladën e murimit varianti më i hershëm njihet të jetë regjistruar nga Vuk Stefan Karaxhiq (Dundes 1996:3) prej një rapsodi hercegovinas dhe i botuar në vëllimin e dytë të përmbledhjes së tij me këngë popullore në Vienë, më 1815, vëllimi i parë ishte botuar më 1814 (Mala prostonarodna slavenoserbska pesnarica, Beč, 1814. Narodna srbska pjesnarica, II deo, Beč, 1815). Më 1824 Karaxhiqi i dërgoi një kopje të koleksionit Jakob Grimm-it dhe ky i fundit e vlerësoi jashtëzakonisht shumë baladën për murimin në kalanë e Shkodrës. Grimm-i e përktheu atë në gjermanisht dhe kjo ishte edhe arsyeja pse kjo baladë pati një njohje edhe më të madhe se baladat e tjera në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Në rajon gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë vijoi mbledhja dhe botimi i folklorit dhe në këtë kuadër edhe mbledhja e publikimi i varianteve të baladës së murimit.

Këtu do të paraqesim shkurtimisht disa të dhëna për botimin e përmbledhjeve të para të këngëve popullore dhe baladave në Ballkan, ku evidentohet edhe balada e murimit (Velaj 2012: 125-155).

*Këngët popullore maqedonase* janë publikuar së pari nga një kroat i Bosnjës, Stefan I. Verkoviç, nën titullin “Këngë Popullore të bullgarëve të Maqedonisë”, (1860). Verkoviç një dekadë e gjysmë më pas, më 1874, botoi një vëllim që e titulloi “Vedat sllave” dhe më 1881 boti një vëllim të dytë të vedave, siç i quajti ai. Pritej të dilte edhe një botim i tretë, por ndërkohë u zbulua se autori kishte falsifikuar gjithçka dhe ky botim u bllokua. Kësisoj Verkoviç është një figurë me dritëhije në historinë e mbledhjes dhe botimit të folklorit maqedonas.

Mbledhësit dhe studiuesit më emblematikë, jo vetëm të folklorit maqedonas, mbeten vëllezërit Miladinov. Vëllezërit Dimitar Miladinov (1810-1862) dhe Konstantin Miladinov (1830-1862), ishin poetë dhe folkloristë

bullgarë nga Maqedonia, autorët e një koleksioni të rëndësishëm të këngëve popullore, "Këngë popullore bullgare", i ribotuar disa here dhe që mbetet botimi më i referueshëm edhe sot. Vëllezërit Miladinovi filluan mbledhjen sistematike të këngëve popullore në vitin 1854. Duke i hyrë një koleksionimi sistematik të materialit folklorik ata shpejt i vunë vetes një detyrë të qartë dhe specifike, të botonin një përmbledhje, e cila të jepte një tablo të plotë të pasurisë së folklorit bullgar. Pas disa tratativave vëllezërit ia arritën të botonin përmbledhjen e parë bullgare të këngëve popullore dhe kjo ishte një lloj pasaporte për prezantimin e folklorit kombëtar, bullgar dhe maqedonas, përpara gjithkujt që interesohej për këngët e mbledhura nga trevat ku banonte kjo popullsi.

*Balada e murimit në botimet bullgare:* Për murimin e njerëzve të gjallë në themelet e ndërtimeve të reja, studjuesi bullgar A. P. Stoillov sjell gjithë informacionin që ai njeh për çfarë që botuar para studimit të tij në Bullgari, që në kohë e ndan rreth një shekull me ne. Sipas besimit, çdo ndërtim i madh kërkon kurban. Baladat ballkanase për murimin e ilustronjë këtë. Parë sipas këtij këndvështrimi, një koleksion i madh këngësh shpërfaqin anë të ndryshme të kësaj çështjeje. Nga N. P. Nedellkoviç, Carigrad, 1872 raportohet një variant i botuar që rrëfen se në lumin Jantra janë murosur Neçno dhe e dashura e tij, Dëshka.

Pas dy vjetësh P.R. Sllavejkov e përdori këtë fakt për çezmën Akë-Balldërë, në rrugën midis Hebibçevos e Harmanlisë dhe shkroi idilin e bukur *Burimi i këmbëbardhës (Izvorët na bellonogata)*, përpunim mbi variantin popullor që për herë të parë u soll në gjuhën e ngritur, të shkruar. Mjeshtrit murosën hijen e vajzës Gergana, që atëherë ajo filloi të ankohej e të thërriste, derisa më në fund vdiq. Ndërsa gjatë vitit 1875 P. Ivanov nxorri në Carigrad përmbledhjen "Vargje", midis të cilëve në faqet 101-108 është përfshirë balada e "Pavle Koprjusju në Mandricë", sipas besimit popullor.

*Balada e murimit te rumunët:* Balada e Mjeshtrit Manole i dedikohet ndërtimit të manastirit të Arxheshit. Manastiri është themeluar nga princi besarab (emri historik: Nagoe Besarab) Negru Voda (emri që del në baladë) në shekullin e gjashtëmbëdhjetë. Me kalimin e kohës, legjenda (balada legjendare) është bërë një nga mitet themelore rumune, miti i flijimit për krijimin, mesazhi i të cilit është se asgjë nuk mund t'i mbijetojë kohës, nëse nuk është e shpirtëzuar nëpërmjet një sakrifice. Legjenda e Mjeshtër Manoles qarkullon në mbi 200 variante ndër rumunët, me pak ndryshime.

*Variantet greke:* Kënga e gruas së muruar haset në tërë territorin grek. Të bën përshtypje fakti që ajo ruhet njëlloj si në brendësi të vendit, ashtu edhe në kufi, edhe në zonat të izoluara ishullore, por edhe në diasporën greke në Azinë ë vogël. Studiuesi bullgar Mihail Arnaudov është ndër të paktët që ka bërë një sistematizim të varianteve ballakanike, ku për nga shumësia, sipas tij, spikatin

variantet greke. Ndër variantet më të hershme të botuara, ai përmend ato të Gustav Majerit, “Indogermanische Forschungen V Anzinger”, mbledhur në Peloponez. Pastaj një variant në Patra më 1887. Arnaudov paraqet më shumë se 14 variante të mbledhura në tërë Greqinë, në fund të shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit të XX.

*Variantet shqiptare:* Të gjitha ato tekste që qarkullonin në rrethet e studiuesve, të cilët u referoheshin botimeve evropiane të kohës, afro një shekull më parë, e nxjerrin shumë të zbehtë dhe periferike baladën shqiptare. Studiuesit ishin pak të informuar në lidhje me baladën e shqiptarëve, teksa merrnin përsipër të bënin punime krahasuese, shpesh shumëplanëshe, midis pesë ose gjashtë kombeve. Variantet shqiptare janë më së shumti për murimin në kala, vendin e dytë e zenë atë për murimin në urë dhe më pak për murimin në objekte kulturi. Mbledhja e varianteve vijoi deri në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë dhe numërohen mbi 150 të tilla në gjithë territorin ku banojnë shqiptarët në Ballkan.

Mbledhësi i parë i folklorit letrar në Shqipëri mbetet Zef Jubani, me veprën “Përmbledhje këngësh popullore dhe rapsodi poemash shqiptare”, botuar më 1871. Jubani shfaq edhe mendime në formë artikujsh për artin dhe posaçërisht për poezinë, për këngët popullore, për rolin dhe rëndësinë e tyre si dhe për muzikën. Studiuesit e gjykojnë ndihmesën e Jubanit të vlefshme për historinë e letërsisë shqipe dhe të mëndimit kritik në përgjithësi, sepse ato janë mendimet e një autori që jetoi brenda vendit. Përmbledhja më cilësore e folklorit mbetet ajo që realizoi Thimi Mitko, “Bleta Shqypëtare”, mbledhur e botuar nga autori në Aleksandri, më 1878. Mitko rezulton të ketë pasur relativisht të qarta kriteret e klasifikimit të materialit folklorik dhe rëndësinë e kontekstin e botimit të veprës që kur ka nisur punën për grumbullimin e materialit. Ai nuk i përmirëson ose devijon variantet e mbledhura. Në këtë përmbledhje shfaqet edhe një variant e baladës së murimit, variant që i referohet murimit në urën e Artës (Mitko: 243)

Referuar të dhënave nga një studim i Nikolae Kostantineskut (Nicolae Costantinecu), shohim se si ka qenë numri i varianteve të raportuara deri pak para fillimit të shekullit të XXI. Ai (Costantinesku 2003: 163) pohon se Georgios Megas raportonte 328 variante greke të baladës për urën e Artës (1973), Lubomira Parpullova raportonte 180 variante bullgare të baladës së murimit (1983), Ion Talosh (Ion Talos) raportonte 280 variante në vargje dhe në prozë për baladën e murimit të rumunët (1997).

Deri në vitin 1996, referuar studiuesit amerikan Alan Dundes (Dundes 1996: 185), del se të botuara dhe të njohura gjerësisht ishin mbi 700 variante, pa përmendur numrin e varianteve të inçizuara. Përmbledhja e Dundes-it për studimet e bëra për baladën e murimit është më shteruesja për sa i përket studimit të varianteve nga gjithë baladistët që janë marrë me këtë baladë dhe përbën një pikë referimi mjaft e rëndësishme për çdo studiues.

## Interpretimi dhe subjektivizmi

Përdorimi dhe zbatimi i “kulturës folk” presupozon të paktën dy anë, sipas Klaus Roth-it, “popujt dhe kulturën e tyre dhe ata që e përdorin atë, zakonisht elitat. Shfrytëzimi i kulturës popullore është bazuar në ndarjen midis të fuqishmëve dhe të pafuqishmëve, midis llojeve të elitave, qofshin ato klerike, politike, socio-ekonomike, ose intelektuale (“mësuar” nga Peter Burke) dhe “njerëzve të zakonshëm”; dhe kjo nënkupton një tjetër dikotomi të rëndësishme të kulturës, midis ekspertëve dhe laikëve. Nën dritën e Iluminizmit të shekullit të 18-të, sundimtarët merkantilistë feudalë ose qeveritë moderne bënë hapin e parë sistematik në përpjekjet për të nxitur studimin e “folkut” dhe kulturës së tij dhe për të aplikuar këtë në mënyrë jo amatore” (Roth 1998: 69-70).

Tendeca për formimin e shteteve komb dhe më pas arritja e krijimit të shteteve kombëtare, nuk u shoqërua vetëm me raportet e përkeqësuar në lidhje me perceptimin dhe studimin e kulturave të fqinjëve. Ajo u shoqërua edhe me dukuri të brendshme, ku grupet periferike, pavarësisht kontekstit, situatës dhe realitetit të tyre, u detyruan t’u bindeshin politikave të qendrës. Shohim disa raste interesante në Evropën juglindore, ku njëri prej tyre është ai Kretës dhe tjetri ai i Sicilisë. Këto raste hedhin dritë mbi mënyrën se si nacionalizmi romantik ndikoi kudo dhe se si u aplikua ai relisht në vendet e kësaj pjese të kontinentit. Herzfeld shprehet kështu:

Një paradoks i njohur i studimeve folklorike është promovimi i leximeve fuqimisht lokaliste në shërbim të gjithpërfshirjes si entitet kombëtar. Në logjikën e nacionalizmit evropian, ky mund të duket një paradoks i pazgjidhshëm. Objekti i kombit-shtet është të unifikojë të gjitha kulturat potencialisht divergjente dhe subjektet shoqërore brenda një kuadri të vetëm, në mënyrë të tillë që të menduarit lokalist pushon së përfaqësuarit kërcënimin e separatizmit politik. Në disa shtete kombëtare, simbioza më harmonike e lokalizmit me nacionalizmin shfaqet në ato rajone që konsiderohen në mënyrë stereotipe si rajone të marginalizuara kulturalisht dhe politikisht dhe rrjedhimisht janë të injektuara në profile të dyfishta, të cilat janë të dyja “të thjeshta”, por edhe të korruptuara nga një gamë e gjerë e elementeve kinse të huaj kulturor dhe “racor”. Një studim i këtyre çështjeve të tensionuara duhet të shmanget në disa nivele, për të shkuar përtej kufizimeve të të dyja fushave: etnografia lokale dhe historia e nivelit kombëtar (Herzfeld 2003: 281).

Nëse do t’i referoheshim kësaj çështjeje, në të gjitha vendet e Ballkanit ne e shohim të manifestuar ndikimin e qendrës drejt periferisë dhe diktatin e qendrës drejt periferisë. Por më së shumti këtu na intereson perceptimi jo



brenda shtetit- komb, por perceptimi i fqinjët gjatë kohës kur secili nga kombet e Ballkanit nisi përpjekjet, ose sapo kishte realizuar krijimin e shtetit komb. Në studimin e folklorit, në rastin e baladës së murimit, që ne e morëm në evidencë, kjo duket mjaft qartë.

Studiuesit më të njohur të kësaj balade në këtë rajon janë përfshirë thujse të gjithë në një lloj gare se cilit komb i përket origjina e baladës. Është një rast i çuditshëm, joshkencor ky lloj rreshtimi, ku studiuesit para se të hulumtojnë vendosin hipotezat e tyre me idenë e pandryshueshmërisë dhe mandej punojnë bazuar në to, pa përfilluar kurrë rastin që këto hipoteza mund të rrëzohen. Ky është një tregues i pastër se si shkenca kthehet në pseudoshkencë, vetëm për t'i shërbyer qëllimit të glorifikimit kombëtar.

Mihail Arnaudov në studimin e tij (*Vgradena nevesta, Studi vërhu bëllgarkite obredi i legendi, Sofje, 1919*) i vendosi në një skemë ndikimi dhe ndërlidhjeje variantet ballkanase të baladës së murimit. Për këtë studiues është e qartë se ka një shtegtim të motiveve nga jugu drejt verilindjes. Ai i mëshon vjetërsisë së varianteve greke dhe jep më pas një lëvizje gjeografike nga trevat greke drejt atyre bullgare. Prej bullgarëve te serbët e te rumunët. Në lidhje varësie me variantet greke ai rendit variantet shqiptare, ndërsa rendit në lidhje të ndërsjelltë variantet shqiptare dhe ato serbe. Sipas skemës së tij, variantet shqiptare shpërfaqin ndikime greke po aq sa edhe serbe.

Duke iu referuar këtij klasifikimi, duhet pohuar se studiuesi ka pasur shumë pak variante shqiptare në dispozicion. Gjithashtu rajonet e sotme të jugut shqiptar dhe të veriut grek kanë pasur një histori që nuk fillon me krijimin e shteteve kombëtare. Folkloristi Zihni Sako (Sako 1967: 87-92) shprehet për origjinën shqiptare të baladës. Ai i referohet Tuqididit për fiset që banonin në këto rajone dhe për gjuhën e tyre barbare. Ura e Artës ndodhej në një rajon ku banonin në masë shqiptarë dhe në vitet 1602-1606, kohë kur ajo u ndërtua, zotërues të këtij territori rezultojnë të kenë qenë familje shqiptare, sipas studiuesit.

Informacione më të vjetër për referenca historike dhe rreth lidhjes rit-baladë sillen gjithashtu në vëmendje. Zihni Sako mendon se balada e ka burimin në një rit tepër të vjetër që shtyhet shumë përpara viteve 527-565 pas erës së re, kur u ndërtua Ura e Adanasë dhe ku u muros një njeri. Ndërkohë që për kalanë e Shkodrës humanisti dhe historiani shqiptar, shkodrani Marin Barleti më 1504 shkruan në "Rrethimi i Shkodrës": Na patën rënë në dorë disa shkrime ...Ishin shkruar aty në gjuhën popullore se një farë Roza me motrën e vet të quajtur Fa qenë themeluesit e parë të Shkodrës e prandaj fortësia e saj quhet Rozafa" (Barleti, 1967: 35). Ekziston një variant i baladës në të cilin gjithçka kryhet nga Roza e Fa sipas veprimeve dhe situatave të baladës së murimit. Por Barleti nuk i përmend situatatat dhe nuk e përmend fljimin. Mbledhësi i këtij varianti është H. Hecquard dhe për këtë çështje shprehet më



hollësisht në një studim Vili Kamsi, i cili pohon se edhe njëherë për vjetërsinë parakristiane të baladës bindemi, nëse u referohemi të dhënave arkeologjike. Zbulime arkeologjike në qytezën e Gajtanit tregojnë se kjo qytezë ka ekzistuar qysh në shekullin e VII dhe se në shekullin e VIII ka pasur një lulëzim të ndjeshëm. Në muret mbrojtëse të qytezës banorët ilirë kanë kryer fljime për perënditë. Varrezat e këtyre fljimeve në trajtën e një rrethi diellor, vendoseshin në këto mure mbrojtëse. Në këtë mënyrë këtu kemi të bëjmë me një rit, me një kult të diellit paraqitur me rrathë gurësh. Në këtë vijë mbrojtëse janë gjendur vazo me kocka fëmijësh. Kjo qytezë ndodhet shumë afër Shkodrës dhe pa dyshim duhet pasur parasysh ndikimi në legjendën për kalanë e Shkodrës (Kamsi 1978: 235).

Karakterit ritual i baladës ishte i gjallë deri vonë në trevat shqiptare. Në lutjen e nuses së muruar që t'i lënë jashtë pjesën e djathtë të trupit dhe sidomos gjirin e djathtë, qëndron dëshira e saj për të realizuar diçka që nuk pati mundësi ta bënte në jetë, rritjen e fëmijës. Në ritet për qumështin e gjirit të lehonave është i njohur zakoni i lyerjs së gjinjve me ujë gëlqeror nga harqet ose kubetë e kalave. Ky ujë i bardhë besonin se ishte qumështi i të murosurës. Riti konsiderohej si burim jete. Zakonisht atë e praktikonin gratë që u mungonte qumështi dhe ky rit kryhej në mëngjes herët sapo lindte dielli.

Pavarësisht kaq shumë fakteve nga fusha të ndryshme, të cilat të gjitha së bashku hedhin dritë mbi origjinën shqiptare të baladës, duhet thënë se kjo origjinë mbetet e diskutueshme për këdo që pretendon origjinalitetin e saj në Ballkan. Nga studimet më të vona mbi këtë baladë është bërë e qartë se ajo nuk ka origjinë autoktone në Ballkan. Gjithsesi, në të dy këndvështrimet, është e qartë ngjashmëria shumë e madhe mes varianteve greke e atyre shqiptare dhe kjo pohohet thuajse në çdo rast kur krahasohen variantet në gadishull.

Mihail Arnaudov në studimin për baladën e murimit gjithmonë priret që variantet greke t'i quajë të origjinës. Ai i përket shkollës historike krahasuese dhe duke pasur njëherësh përkatësinë ballkanase, mund të renditet në grupin e studiuesve që ka qenë relativisht objektiv. Mbase edhe mungesa e varianteve shqiptare e ka bërë autorin që të flasë me rezerva për renditjen që zë balada shqiptare në skemën e prezantuar nga ai. Në fakt, sipas të gjitha kritereve me të cilat operon, variantet shqiptare, qoftë edhe vetëm me ato që ai ka pasur në dorë, (të cilat kanë qenë jo më shumë se 6-7), autori mund të dilte në përfundime më objektive. Megjithatë, edhe ky klasifikim, që është i hershëm në kohë dhe i tejkaluar mbase sot në studimet për baladën e murimit në gadishull, tregon ende për mënyrën se si ballkanasit e kanë parë njëri-tjetrin.

Më i çuditshëm dhe mjaft i papritur është qëndrimi i një studiuesi bashkëkohor i cili ka një qasje sinkronike ndaj baladës. Roderick Beaton në studimin e tij ("The Greek Ballad. "The Bridge of Arta" as Myth"), i cili është përfshirë në përmbledhjen e rëndësishme të Alan Dundes-it, (Beaton 1996: 68)

sjell një shembull se si studiues me standarde të larta si Megas dhe Vargyash nuk ranë në nivele të tilla si Zihni Sako, i cili pretendonte se edhe Ura e Artës, edhe Kalaja e Shkodrës paskëshin qenë shqiptare prej përkatësie dhe kulture. Në fakt studiuesi Zihni Sako sjell përpara çdo studiuesi dhe lexuesi fakte se si territori ku është sot Ura e Artës, në kohën kur ajo është ndërtuar ka qenë në zotërimin e një shqiptari dhe nëse është ndërtuar në territorin e tij dhe nëse ajo ishte tokë e tij, kjo s'ka vend për komente të asnjë lloji. Koncepti i shtetit kombëtar ishte shumë larg prej asaj kohe. Studiuesi shqiptar thjesht sjell një fakt kadastral dhe ua bashkangjiti të tjerëve, siç do të bënte çdo studiues tjetër serioz që do i ishte qasur studimit të baladës sipas metodës historike krahasuese.

Duhet theksuar se shpesh njohja vetëm përmes paragjytimeve e shtrembërimeve, ose mosnjohja e kontekstit historik dhe kulturor kanë çuar në përfundime të cilat, jo vetëm nuk janë shkencore, por tingëllojnë absurde dhe pa kuptim.

Sot, pas kësaj distance kohore (Velaj 2012: 227-232), studiuesit bashkëkohorë vërejnë se nuk është bërë shumë për analizën e baladës, në kuptimin e mirëfilltë, kur flasim për një qasje të vërtetë shkencore. Studiuesi amerikan Alan Dundes pohon se ndjehet i zhgënjyer teksa u referohet kolegëve të tij, paraardhës dhe sheh në studimet e bëra këto 150 vjet, kryesisht përpjekje për të mbrojtur repertorët nacionalë të baladës dhe jo për të bërë një hulumtim shkencor të pandikuar dhe pa paragjytime.

Në një shekull e gjysmë ballkanasit kanë punuar pikërisht për të vërtetuar se balada e ka origjinën nga vendet të cilëve ata u përkasin. Nëse shohim një kronologji të studimeve të baladës së murimit me atë të vetë zhvillimit të folkloristikës si shkencë, duket se ka një paralele të përputhur kohore. Por ndërsa folkloristika hodhi dritë mbi shumë probleme të eposit, të përrallës dhe këngëve të tjera popullore, ajo nuk e kreu dot misionin e saj për sa i përket baladës.

Pse një grindje kaq e madhe për përkatësinë e baladave dhe pse pikërisht për këtë zhanër? Edhe për eposin vazhdimisht janë parë tendenca nacionaliste në studim, por, krahasuar me baladën, grindjet për eposin janë më të vogla.

Disa studiues, kryesisht ata që janë marrë me baladat angleze dhe ato të vendeve nordike, mendojnë se grindjet për baladën bazohen kryesisht sepse ajo lulëzoi fort si zhanër i publikuar në kohën kur sapo po niste lëvizja për krijimin e shteteve kombëtare. Ndërsa një arsye tjetër se pse studiuesit e kanë lakmuar kaq shumë përkatësinë kombëtare të baladës, mbetet ajo sipas së cilës baladat janë një zhanër aristokratik, krahasuar me arsenalin tjetër të folklorit. Kësisoj, duke vërtetuar se balada e ka origjinën në një vend të caktuar, detyrimisht atij vendi i atribuohet edhe një vlerë më e madhe në avantazh të perceptimit si komb më i qytetëruar.

## Studimet bashkëkohore

Deri para dy dekadash gjendja e studimit të baladave ishte kjo që përshkruam më lart. Në ato vende ku balada ishte studiuar më shumë, kishte më shumë variante të botuara dhe më shumë studime në qarkullim, metoda ishte historike krahasuese, por e përdorur me paragjykime. Po të shihet me kujdes studiuesit ndiqnin këtë itinerar: fiksonin që më parë tezat që duhet të mbronin dhe i qaseshin materialit, duke përfshirë çdo gjë që nuk ilustronte qëllimin fillestar të tyre. Gjithashtu për krahasim merreshin aq variante sa mendohej se e ilustronin qëllimin dhe merreshin ato variante, të cilat i shërbenin qëllimit. Balada nuk shihej si një shumësi variantesh, si një pluralitet. Kjo bëri që kurrë të mos krijohesh një hartë serioze e gjeografisë së baladës dhe kurrë të mos merreshin në konsideratë variantet që ndoshta do të çonin në kuptimin e thellë të saj.

Metoda krahasuese është mjaft e nevojshme për studimin e baladës, siç shprehen studiuesit e sotëm, por ajo duhet zbatuar me rigorozitet dhe jo duke bërë zgjedhje selektive, që në fund të fundit çojnë në përfundime krejt të njëanshme dhe pa mundësi për të arritur në rezultate objektive.

Se sa shumë e ka dëmtuar kjo mënyrë studimi vetë folkloristikën dhe studimin e baladës në veçanti, këtë e pohojnë sot thuajse të gjithë njëzëri specialistët e kësaj fushe.

Qasja diakronike, duke shkuar në thellësi të shekujve, për të zbuluar lidhjet kulturore, jo vetëm në zinxhirin e traditës gojore, por të të gjithë artefakteve që kanë mbetur nga kultura në kohëra, ka dominuar studimet për baladat dhe jo rrallë, studimet arkeologjike, historike, antropologjike, i kanë ardhur shumë në ndihmë kësaj metode.

Metoda historike krahasuese, në mos ka arritur të sjellë një tablo të qartë të baladës, në këtë pikë ku jemi sot, ka arritur të paktën të na bëjë të kuptojmë, se çfarë ka qenë e mangët në mënyrën se si ajo u aplikua për kaq shumë vite. Dhe nëse do të donim ta merrnim sërish në konsideratë, me siguri ajo çfarë duhet riparë është që të analizohen sa më shumë variante të jetë e mundur, përndryshe nuk kemi mundësi të arrijmë në përfundime serioze shkencore. Sot është bërë e qartë se balada e murimit nuk ka origjinë ballkanike, me të paktën 700 variante të studiuara nga Alan Dundes dhe studiuesit e tjerë, ku përfshihen edhe variantet indiane të saj, studiuesi argumenton pse balada nuk është ballkanase dhe se si atë mund ta kenë sjellë ciganët në këtë rajon. Ai pohon se e çudit injorimi që i kanë bërë studiuesit ballkanas dhe ata të pjesës tjetër të botës, që e kanë këtë baladë në fondin e trashëgimisë së tyre kulturore. Asnjëherë nuk janë përmendur variantet indiane të baladës dhe asnjëherë askush nuk është interesuar seriozisht që t'i marrë ato në konsideratë. Në fakt, variantet e baladës të mbledhura nga ciganët në Ballkan kanë qenë gjithashtu

të injoruar. Vetëm në dekadat e fundit ka pasur një interes për botimin e tyre dhe po ashtu për regjistrimin zanor. Dundes pohon se bazuar në shkollën historike gjeografike, shkollë skandinave, e cila bazohet në shtegtimin e motiveve, shumë studiues kanë arritur në konkluzione interesante për përrallat, por për baladën nuk kanë përdorur të njëjtën qasje. Dundes sqaron se në thelb kjo shkollë mund të ishte aplikuar dhe mund të kishte sjellë rezultate mjaft pozitive dhe sot studimet për baladën nuk do të ishin në stade kaq fillestare, po të ishte punuar seriozisht me mbledhjen dhe hartën e të gjithë varianteve.

Përpara studieve është shtruar çështja e metodës, e shkollës. A është adekuate metoda historike krahasuese, apo duhet përdoruar një metodë tjetër? Në fakt edhe kësaj pyetjeje duket se po i jepet përgjigje, duke u nisur nga llojet e studimeve që bëhen sot në fushë të folklorit.

Sot qasja në studimet për baladën është sinkronike, jo më diakronike, siç e pamë më lart. Ndërsa interesi shkencor nuk duket se ndikohet më nga interesi nacional, si përpara. Kështu që, edhe pse ka humbur shumë kohë në studimet e baladës, folkloristika duket se e ka gjetur rrugën e duhur të studimeve të saj sot e më pas. Në qasjen sinkronike theksi vihet te semantika, te kuptimi i thellë i baladës.

## Përfundime

Për baladën e murimit studiuesit ballkanas kanë qenë vazhdimisht të vendosur në pozicione të cilat mjaft herë i kapërcejnë kriteret shkencore që do të duheshin për studimin e baladës. Varësisht nga nacionaliteti ose afiniteti i studiuesve u përcaktua edhe rrjedha e këtyre studimeve, deri në fund të shekullit të njëzetë. Në studimet për këtë baladë evidentohet kjo qasje, e cila aktualisht po kapërcehet. Mirëpo është me shumë interes të shihet se si po trajtohet kjo trashëgimi në studime. Studiuesja Arbnora Dushi shprehet se edhe ekzistenca e interpretimeve të vazhdueshme dhe shpesh edhe kontradiktore, veçanërisht në lidhje me origjinën e baladës së murimit, në vend se t'i përçajë, do të duhej t'i bashkojë folkloristët rreth qëndrimit se prania e sa më shumë interpretimeve do të duhet të pranohej sikur edhe prania e varianteve në llojet folklorike. Më shumë se varfëri e mendimeve, interpretimet qoftë edhe me ngarkesa nacionaliste, do të duhej të shiheshin si pasuri interpretimesh (Dushi 2018:44).

Shumë studiues përcaktojnë se Ballkani më shumë se dallime ka ngjashmëri dhe kjo evidentohet edhe në fushën e folklorit. Studiuesi Shaban Sinani shprehet se prania e motiveve të njëjta dëshmon për raporte fqinjësore, por në anën tjetër, po kjo fqinjësi ka ndikuar në ruajtjen me xhelozi të tipareve të veçanta, të veçorive etnike, pasojë kjo që e ka krijuar instikti i vetëmbrojtjes nga kërcënimi i fqinjëve (Sinani 2006:39).

Në rastin e baladës së murimit, interesi për ta studiuar atë objektivist lidhet drejtpërdrejt me njohjen e trajtimeve të mëparshme, por mbi të gjitha lidhet me mbledhjen dhe botimin shterues të të gjithë varianteve dhe në krijimin e një harte të tyre, e cila nuk është vetëm ballkanike dhe nuk mund të studiohet vetëm brenda kufijve të Ballkanit. Siç u shprehëm më sipër, në studimet bashkëkohore më shumë vëmendje po i kushtohet interpretimit dhe jo origjinës së kësaj balade, për përkatësinë e së cilës nuk ka më rivalitet dhe as prirje për epërsi.

### Bibliografi

- Anderson, B. (1983) *Imagined. Communities. Reflections on the Origin and Spread of Nationalism*, Verso, London-New York.
- Barleti, M. (1967) “*Rrethimi i Shkodrës*”, botim i dytë, Tiranë.
- Costantinescu, N. (2003) *Contexts and Interpretations: The Walled-Up Wife Ballad and Other Related Texts*, “The Flowering Thorn”, University Press of Colorado, Utah State University Press, 161-167.
- Dundes, A. (1996) “*The walled up wife. A casebook*”, University of Wisconsin, 185-204.
- Dushi, A. (2018) *Balada e murimit në traditat gojore të Ballkanit: çështja e origjinës nën dritën e disa interpretimeve*, në “Gjurmime Albanologjike”, nr. 48, 25 – 44.
- Herzfeld, M. (Apr.2003) *Localism and the Logic of Nationalistic Folklore: Cretan Reflections*, Comparative Studies in Society and History, Vol. 45, No. 2, 281-310.
- Hupchick, D. (2002) *The Balkans*, Palgrave Macmillan, 189-190.
- Kamsi, V. (1978). “*Legjenda e kështjellës së Shkodrës si tregues i një tradite të lashtë të epikës legjendare shqiptare*”, “Çështje të Folklorit Shqiptar”, nr. 2, 235-238.
- Mitko, Th. (1981), Vepra, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë.
- Roth, K. (1998) *Folklore and Nationalism*, Ethnologia Balkanica, Vol. 2, 69-70.
- Sako, Z. (1967), *Balada shqiptare për murimin dhe elementet e saj të përbashkëta me motërzimet ballkanike*, “Studime filologjike”, nr. 2, 87-92.
- Sinani, Sh. (2006) *Ura dhe kështjella*, Argeta – LMG, Tiranë
- Velaj, O. (2012) *Balada shqiptare në kontekst ballkanik*, (dorëshkrim), i qasshëm në linkun e QSA-së <<https://documents.tips/documents/olimbi-velaj>>
- Willson, W. (Spring 1973) *Herder, folklore and nationalism*, Journal of popular culture, vol. 6, Issue 4. P. 819-835.

Olimbi Velaj

**Folklore in the Balkans, Subjectivity in the Last Century Studies,  
the Case of the Walled up Wife's Ballad**

Summary

The ballad of the walled up wife began to be recorded in the nineteenth century until the middle of the twentieth century in Balkan. The collection and then the interpretation of this ballad has a national history for each of the peoples. This is closely related to the formation of national states and to the Romanticism that has been experienced in the Balkans as a renaissance of the values of national legacies and the time of separation from the centuries-old Turkish rule. Here we will shed light on way how this tendency has affected even scholars and how they have been involved in subjective, or nationalistic approach, far away from real and serious studies.